



Çështje me interes:

- * Konferenca e parë e ASSE-s
- * Rritja e ASSE-s
- * *in esse*: English Studies in Albania

Në këtë numër:

- Konferenca e parë e ASSE-s 1
- Numri i parë i *in esse* 2
- ASSE një realitet me perspektivë 2
- Procedura të anëtarësimit në ASSE 3
- Call for papers 3

Konferenca e parë e ASSE-s

Konferenca e parë e ASSE-s u mbajt në Vlorë, në mjediset e Universitetit të Vlorës ‘Ismail Qemali’. Konferenca kishte një titull domethënës ‘Only Connect..’. Interesi i madh i shfaqur ndaj këtij aktiviteti nga kolegë brenda dhe jashtë vendit e bënë këtë aktivitet mjaft frutdhënës si në aspektin shkencor ashtu edhe në atë bashkëpunues.

Numri i aplikimeve ishte i konsiderueshëm. Ndër rreth 200 aplikime u përzgjodhën gati 130 aplikime. Në konferencë morën pjesë 100 referues nga Shqipëria dhe shumë vende të tjera të botës. Vlen për tu përgëzuar pjesëmarrja e madhe e kolegëve nga

universitetet kryesore të Shqipërisë. Ky është një ogur premtues jo vetëm për ASSE-n, por mbi të gjitha, për rritjen e bashkëpunimit për organizmin e aktiviteteve të tilla në mbarë Shqipërinë duke krijuar kështu mundësi të reja dhe premtuese për kërkimin shkencor në gjuhën angleze.

Në konferencë u trajtuan tema me mjaft interes nga fusha të ndryshme të studimit në gjuhën angleze si nga letërsia dhe kultura e vendeve anglishtfolëse, gjuhësia, pragmatika, anglishtja për qëllime specifike, studimet kulturore, përkthimi, mësimdhënia etj. Në shumë raste referuesit sollën pikëpamje të reja dhe



intriguese në lidhje me tematikat e interesit të tyre.

I gjithë informacioni në lidhje me konferencën dhe vijueshmërinë e saj mund të merren në lidhjen <http://www.assenglish.org/onlyconnect/>.

Numri i parë i *in esse*

Konferenca e parë e organizuar nga ASSE solli edhe përrurimin e numrit të parë të buletinit shkencor të kësaj shoqate të titulluar në mënyrë domethënëse *in esse: English Studies in Albania*. Për t'i dhënë një kuptim të veçantë, por njëkohësisht edhe të thjeshtë numrit të parë, ne e titulluam atë “English(es).” Thirrja për propozime e publikuar në shumë *website*, ndër to edhe në

atë të ESSE-s tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve nga vende të ndryshme. Numri i parë përmbledh gjithsej tetë artikuj të përzgjedhur nga shumë artikuj të dorëzuar për botim. Këto artikuj janë nga fusha të ndryshme të studimit të gjuhës angleze si nga letërsia, gjuhësia, mësimdhënia dhe përkthimi. Ato ngërthejnë çështje interesante për sa i përket vetë termit ‘anglisht’, duke e nënkuptuar atë në një plan më të

gjerë, të shtirë përtej kufijve gjeografikë apo gjuhësorë të botës anglishtfolëse.

Ndërkohë është duke qarkulluar thirrje për propozime për numrin e dytë të buletinit, i cili do të titullohet “Trends”. Për më shumë mund të konsultoni thirrjen e botuar në listën me thirrje në faqe 4 ose të konsultoni website-in e ASSE-s, në <http://www.assenglish.org/publications/>.

ASSE një realitet me perspektivë



Veprimtaritë e organizuar nga ASSE për vitin 2011 tregojnë se kjo shoqatë ka një ambicie dhe dëshirë për të kontribuar në çuarjen përpara të studimeve në gjuhën angleze në Shqipëri. Shembull i qartë i kësaj janë jo vetëm konferenca e organizuar me sukses në qershor 2011 dhe botimi i numrit të parë të buletinit, por, mbi të gjitha, interesi i madh e në rritje i studiuesve të kësaj fushe në të gjithë vendin. Në fund të fundit, vetë misioni kryesor i shoqatës është të mbledhë së bashku në organizime të tilla, studiues të gjuhës angleze nga të gjitha universitetet e Shqipërisë dhe jo vetëm.

Përveç organizmit të këtyre aktiviteteve të para, ne patëm kënaqësinë të kishim të pranishëm gjatë konferencës edhe ekzekutivin e ESSE-s,

presidentin, Prof. Fernando Galván, sekretaren, Dr. Slávka Tomáščíková, dhe drejtorin e thesarit, Prof. Tim Caudery. Ekzekutivi i ESSE-s zhvilloi mbledhjen e vet të radhës në ambientet e Hotel Vlorë International në datën 10 qershor 2011, një ditë para hapjes së punimeve të konferencës. Ata ishin mjaft entuziastë për vizitën e tyre në Vlorë, por mbi të gjitha për arritjet që ASSE ka pasur në një kohë kaq të shkurtër.

Ne jemi po aq krenarë që sot ASSE e ka dyfishuar numrin e anëtarëve të saj që nga çasti kur aplikua në ESSE për anëtarësim dhe premtion të rritet çdo ditë e më shumë.



Procedura të anëtarësimit në ASSE

Më poshtë po ju njohim me nenet 4 dhe 5 të statutit të ASSE-s që lidhen me anëtarësimin dhe procedurat e anëtarësimit. Të interesuarit për të aplikuar për tu bërë anëtarë të ASSE-s mund të konsultojnë *website*-in e ASSE-s dhe më pas të plotësojnë formularin përkatës për aplikim anëtarësimi në ASSE.

Neni 4 – Anëtarësimi

ASSE është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimdhënës, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues, mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësimdhënës të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre mësimdhënës, kërkues e shkencor.

Anëtarë nderi: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

Neni 5 – Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikantit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësim e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përfshihen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.

Call for papers

Më poshtë do të gjeni një listë me thirrje për botime të ndryshme. Ndër to do të gjeni thirrjen për dorëzimin e artikujve të paraqitur në konferencën e parë të ASSE-s “Only Connect...” të organizuar në datat 11-13 qershor 2011 si dhe thirrjen për artikuj për numrin e dytë të *in esse: English Studies in Albania*, i cili titullohet “Trends” .

Only Connect ... Call for Paper Submission

All papers presented at the conference will be considered for publication in the two 2011 volumes of *in esse: English Studies in Albania*. **The deadline for submissions is 30 September 2011.** Articles should not exceed 6000 words. Submissions should be sent as an MS e-mail attachment to onlyconnect@assenglish.org. Please include a 250-word abstract and 4-5 keywords. Submissions should conform to the 16th edition of The Chicago Manual of Style, <http://www.chicagomanualofstyle.org/home.html>. *in esse* uses a "References" format together with author-date-page citations in the body of the article. **Spelling should conform to The Oxford English Dictionary except for cited material.**

Questions about formatting should be addressed to Armela Panajoti, General Editor of *in esse*, armelap@assenglish.org.

Trends

in esse: English Studies in Albania

Deadline for submitting articles: 15 October 2011

ASSE (Albanian Society for the Study of English) and the Department of Foreign Languages, University of Vlora would like to announce this call for papers for contributions for its second issue of *in esse: English Studies in Albania*, a scholarly journal devoted to the promotion of original work in linguistics, literary and translation studies and language teaching by scholars working in Albania and abroad.

The second issue, following the first one entitled *English(es)*, marks an important progress in the promotion of English studies in Albania. This issue not only reaffirms our aim of becoming one of the most credible sources for the development of these studies in Albania and not only, but also challenges scholars by calling their attention to the latest tendencies, perspectives and developments in the study of literature, language, and culture of English-speaking countries.

Thus, the title of this issue is *Trends* and is intended to bring together new and intriguing tendencies, fashions, perspectives and responses in any of the following:

- British and Commonwealth Literature
- American Literature
- Afro-American Literature
- Literary Theory and Criticism
- Linguistics
- Pragmatics
- Semantics
- Semiotics
- English for Specific Purposes
- English language Teaching
- Translation Studies.

Articles should not exceed 6000 words. Submissions should be sent as an MS e-mail attachment to Armela Panajoti (armelap@assenglish.org) or Marsela Turku (mturku@assenglish.org).

Please include a 250-word abstract and 4-5 keywords. Submissions should conform to the 16th edition of The Chicago Manual of Style. *in esse* uses a "References" format together with author-date-page citations in the body of the article. Spelling should conform to *The Oxford English Dictionary* except for cited material.